



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.370/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Xhavit Gaxherrit kryesues i Komisionit Komunal Zgjedhor, KKZ, në Junik, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Junik me objekt të çështjes, mbajtja e tubimit publik gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, pa autorizim nga Komisioni Komunal Zgjedhor (KKZ), në Junik, në seancën e panelit, të mbajtur me datë 12.02.2021, mori këtë::

V E N D I M

PRANOHET e bazuar ankesa e Xhavit Gaxherrit kryesues i Komisionit Komunal zgjedhor në Junik,, Anr.370/2021 e datës 11.02.2021 për shkak të mbajtjes së tubimit publik nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), pa autorizim nga Komisioni Komunal Zgjedhor (KKZ), në Junik gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, ndërsa subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 6,000.00 (gjashtëmijë) euro, për të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të shqiptimit të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Me datë 11.02.2021 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Xhavit Gaxherri, kryesues i Komisionit Komunal Zgjedhor, KKZ në Junik, me të cilën pretendon se subjekti politik LVV në Junik ka organizuar tubim elektorale pa e përfillur Rregullën Zgjedhore nr. 13/2013 neni 4 paragrafi 2, dhe si e tillë ky tubim mund të cilësohet i pa autorizuar. Parashtruesi i ankesës thekson se tubimi është mbajtur në sheshin Edmond Hoxha, në Junik me fillim nga ora 14:30 – 14:50 ku pjesëmarrës në tubim ishin mbi 50 persona.

Në përgjigjen në ankesë të datës 11.02.2021, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), e kundërshton dhe e vlerëson si të pabazuar ankesën e paraqitur nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve- Junik, duke i konsideruar si të pabazuara pretendimet ankimore me arsyetimin se Lëvizja Vetëvendosje – qendra në Junik përmes rrjetit social facebook ka theksuar se “ U.D “Presidentja e Kosovës Vjosa Osmani dhe kryetari i lëvizjes Vetëvendosje Albin Kurti kanë takuar fillimisht strukturat e Lëvizjes Vetëvendosje. Më pastaj kanë bërë homazhe tek shtatorja e Edmond Hoxhës, ku ju drejtuan qytetarëve duke ju premtuar përmirësim në çdo

institucion dhe vëmendje për Junikun në sektorin e bujqësisë dhe turizmit si dhe kanë vizituar edhe kompaninë Luna SHPK në Junik. Më tutje parashtuesi i përgjigjes në ankesë thekson se sa i përket pretendimit të palës ankuese lidhur me një postim të një personi që jeton në botën e jashtme, i njëjti nuk ushtron asnjë funksion në Lëvizjen Vetëvendosje, dhe termi i përdorur tubim elektorale nga i njëjti nuk është i vlefshëm pasi që nuk ka pasur lidhje me organizimin dhe as me njohuritë për termat e përdorur.

Prandaj, sipas parashtuesit të përgjigjes në ankesë, Lëvizja Vetëvendosje – qendra në Junik nuk ka organizuar tubim elektorale në sheshin “Edmond Hoxha”, por janë bërë vetëm homazhe andaj nuk ka qenë e nevojshme që të njoftohet KKZ- Junik, pasi që vizita në vende të caktuara të komunës së Junikut brenda fushatës nuk konsiderohet tubim elektorale, nuk ka pasur as binë, as mikrofon dhe asgjë tjetër që konsiderohet si aksesore në tubim elektorale. Si dëshmi kësaj përgjigjeje në ankesë, Lëvizja Vetëvendosje i ka bashkangjitur foto ku dëshmohet deklarata e Vetëvendosjes- Junik si dhe deklaratën e Lulzim Gacaferrit që jeton në Gjermani lidhur me njoftimin e tij në rrjetin social facebook.

Në fund parashtuesi i përgjigjes në ankesë Lëvizja Vetëvendosje i ka propozuar PZAP-it, që ankesën A.nr.370/2021, ta refuzojë si të pabazuar pasi që nuk qëndrojnë pretendimet se është shkelur neni 4 paragrafi 2 i Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Neni 7 paragrafi 2 i Rregullës Zgjedhore 13/2013 përcakton se nëse ZLKK-ja ose zyrtaret e Policisë së Kosovës kur hasin në tubim të paautorizuar, ata duhet ta informojnë PZAP-in, për hollësitë e tubimit publik për kohën, vendin, numrin e pjesëmarrësve në atë tubim publik, për subjektin politik që e mban tubimin publik, si dhe çdo informate tjetër relevante lidhur me atë tubim publik, ndërsa neni 9 i kësaj rregullore si dhe nenin 46 i LZP-së, përcakton qartë se PZAP-i, mund të shqiptoj sanksione subjektit politik që ka shkelur dispozitat e kësaj rregullore.

Andaj Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara pasi që neni 4.2 i Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, lidhur me Fushatën Zgjedhore dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike, përcakton qartë se subjekti i certifikuar politik që dëshiron të organizojë dhe të mbajë një tubim publik gjatë periudhës së fushatës zgjedhore duhet që të Zyrtari i Lartë Komunal i Zgjedhjeve i asaj Komune (ZLKK), të dorëzojë formularin e plotësuar të Njoftimit për Mbajtjen e Tubimit Politik (FNJMTP) me së voni shtatëdhjetë e dy (72) orë përpara.

Me këtë rast Paneli duke u mbështetur në dispozitën ligjore konstatoi se subjekti politik LVV, nuk e ka njoftuar organin kompetent të Komunës, në këtë rast ZLKK, për mbajtjen e këtij tubimi ashtu siç parashihet me dispozita ligjore në fuqi, andaj mbi këtë bazë dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 dhe 120.1.c të LZP-së, PZAP-i, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me përgjigjen e subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ku thekson se ky subjekt politik ka bërë vetëm homazhe në sheshin Edmond Hoxha, në Junik dhe Paneli vlerësoi se

me këtë përgjigje subjekti politik LVV, nuk e mohon se e ka realizuar një vizite të tille në Junik por se e njëjta thekson se ka bërë vetëm homazhe, andaj Paneli vlerëson se në rastin konkret subjekti politik në fjalë nuk e ka paraqitur dhe nuk ka lajmëruar, këtë aktivitet të fushatës zgjedhore ashtu siç parashihet me Rregullën Zgjedhore Nr.13/2013.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, ka marrë pjesë një numër i konsiderueshëm të njerëzve duke iu drejtuar me fjalët në këtë tubi, me të cilën është shkelur dispozita e lartcekur e LZP-së, si dhe neni 7 paragrafi 2 i Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, ku parashihet se subjektet e certifikuar politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t'i bëjnë në pajtueshmëri me Rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për me tepër edhe vet subjekti në përgjigjen në ankese thekson se fillimisht ka pasur takim me strukturat, aktivistët dhe me qytetaret, çka vet kjo përgjigje e konfirmon faktin e tubimit me qytetaret.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë Paneli, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij e njëjta e ka mohuar shkeljen e tillë.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, lidhur me nenin 9 të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 370/2021 më datën 12.02.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.